



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.112/2016

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazić kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatit Elmi Thaqi nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega Drenas, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Drenasit të datës 04.12.2016, në seancën e panelit të mbajtur me 07.12.2016, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa Anr.112/2016 e datës 05.12.2016 me të cilin është pretenduar se kandidati për kryetar të Komunës së Drenasit Elmi Thaqi nga radhët e subjektit politik AKR, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme ka bërë thirrje për votim përmes rrjetit social Facebook.

#### Arsyetim

Parashtruesi i ankesës Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, me datën 05.12.2016 ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se me datë 04.12.2016, gjatë ditës së zgjedhjeve rreth orës 14:00, kandidati Elmi Thaqi, përmes rrjetit social Facebook, ka bërë thirrje për votim, veprime këto të cilat sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës, nenin 36 par 1 pika b).

Parashtruesi i ankesës, parregullsisë së evidentuar i ka bashkangjitur si dëshmi një kopje të postimit.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AKR, lidhur me ankesën e datës 05.12.2016, të parashtruar në PZAP, nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Internews Kosova si dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 07.12.2016 në ora 09:00.

Subjekti politik AKR, në përgjigjen në ankesë, thekson se postimi i datës 04.12.2016 në facebook të cilin ankuesi e paraqet si shkelje, nuk është postuar nga kandidati Elmi Thaqi, edhe pse ky postim është bërë nga dikush tjetër, nuk ka thirrje për votim e as për mbështetje të çfarëdo forme tjetër. Me tutje subjekti politik AKR në përgjigje

thekson se është një foto e një bashkë partiaku të AKR-së, qe e ka postuar në facebookun e vet personal dhe i cili sipas AKR-së nuk ka lidhje me pretendimin apo ankesën të cilën e paraqesin ankuesit. Subjekti politik AKR konsideron se kjo ankesë është plotësisht e pabazuar, nuk ka prova dhe nuk ka kurrfarë shkelje të nenit 36.1 siç pretendon ankuesi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj pretendimet e palëve në procedurë, dhe të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjeti se **ankesa është e pabazuar** për këto arsye:

PZAP-i, vlerëson se pretendimi i parashtruesit të ankesës, se kandidati Elmi Thaqi nga radhët e subjektit politik AKR, ka bërë thirrje për votim përmes rrjetit social Facebook gjatë ditës së zgjedhjeve, është i paqëndrueshëm dhe nuk është argumentuar nga parashtruesi i ankesës, pasi qe nga fotografia e ofruar, si provë nuk vërehet dhe nuk mund të vërtetohet koha e postimit dhe asnjë detaj tjetër, andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë, bazuar në nenin 5 par.7 pikat b) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.112 /2016 më datën 07.12.2016.



v.d

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.